

LIGJI
MBI QARKULLIMIN E PASURISË SË PALUAJTSHME

Ky Ligj është shpallur në "Gazetën zyrtare të KSAK", nr. 45/81, 29/86, 28/88.

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Me këtë ligj rregullohet qarkullimi i tokës bujqësore dhe i tokës ndërtimore, i pyjeve dhe i tokës pyjore, i ndërtesave, banesave dhe i lokaleve afariste dhe i pasurive tjera të paluajtshme (në tekstin e mëtejme: pasuritë e paluajtshme) përvec bazave të marrëdhënieve pasurore dhe juridike, të cilat në ligjin republikan janë rregulluar në mënyrë unike për territorin e Republikës.

Dispozitat e këtij ligji aplikohen edhe për qarkullimin e pjesëve ideale të pronësisë së pasurive të paluajtshme.

Neni 2

- është shlyer -

Shiqo: neni 1-28/88

Neni 3

Kur bartësi i të drejtave të pronësisë sipas bazës së trashigimit fiton pasurinë e paluajtshme mbi kufijtë e përcaktuar me ligj, ose kur i pushon kushti sipas të cilit ka mund të ketë të drejtë pronësie në këtë pasuri të paluajtshme, ka për detyrë që këtë t'ia paraqesë organit komunal kompetent për punë pasurore-juridike në afat prej tridhjetë ditësh prej ditës kur aktvendimi mbi trashëgimin merr formën e prerë, përkatësisht prej ditës së pushimit të kushteve sipas të cilave ka mund të ketë pasurinë e paluajtshme të atillë në pronësi dhe të deklarohet për zgjedhjen e pasurisë së paluajtshme në të cilën e mban të drejtën e pronësisë.

Tepricën e pasurisë së paluajtshme bartësi i të drejtave mund të tjetërsojë në afat prej tre vjetësh, ndërsa lokalin afarist të trashëguar, me lejen e organit komunal kompetent, mund ta shëndrojë në lokal banesor në qoftë se me këtë nuk i kalon kufijtë e të drejtave të pronësisë në lokalin e banimit.

Në qoftë se bartësi i të drejtave të pronësisë nuk bën zgjedhjen e pasurisë së paluajtshme në të cilën e mban të drejtën e pronësisë, organi komunal i administratës, kompetent për punë pasurore-juridike cakton me aktvendim se cila pasuri e paluajtshme e trshëguar si tepriçë bëhet pronësi shqërore. Aktvendimi merret pas kalimit të afatit nga alineja 2 e këtij neni, në bazë të lajmërimit të bartësit të të drejtave, pronësore apo sipas detyrës zyrtare.

II. QARKULLIMI I TOKAVE DHE NDËRTESAVE

Neni 4

Toka bujqësore dhe për ndërtim, pylli dhe toka pyjore nuk mund të tjetërsohen nga pronësia bujqësore, në qoftë se për tokën bujqësore, pyllin dhe tokën pyjore me ligj nuk është caktuar ndryshe.

Personat shoqëror-juridik mundën në mes vedi t'i bartin pasuritë e paluajtshme nga paragrafi 1 i këtij neni pa shpërblim ose me shpërblim i cili nuk mund të jetë më i madh se lartësia e vlerës së deponimeve të bëra në këtë tokë, përkatësisht në këtë pyll.

Neni 5

Personat shoqëror-juridik, tokën bujqësore jashtë kompleksit të tokës bujqësore, në të cilën kanë të drejtë disponimi, baartësit të së drejtës së pronësisë mund të ia japin në ndërrim për tokë tjetër.

Organizata e punës së bashkuar dhe personi tjetër shoqëror-juridik me shpërblim mund të tjetërsoj tokën bujqësore nga pronësia shoqërore në dobi të bartësit të së drejtës në qoftë se toka e tillë është jashtë kompleksit të tokës bujqësore dhe në posedime të vogla dhe të shpërndara, me kusht që mjetet e marra monetare t'i përdorë për blerjen e tokës tjetër bujqësore në afatin prej dy vjetësh prej ditës së tjetërsimit.

Për tjetërsimin nga paragrafi 1 dhe 2 të këtij neni nevojitet pëlqimi paraprak i kuvendit të komunës në territorin e të cilit gjindet toka bujqësore.

Neni 6

Organizata e punës së bashkuar mundet, me kompenzim, ta tjetërsojë nga prona shoqërore pyllin dhe tokën pyjore në të cilat nuk është e mundur të organizohet afarizmi racional (pyje të vogla të izoluara, enklave ose gjysmëenklave në pyjet për të cilat ekziston e drejta e pronësisë etj.), me kusht që mjetet e realizuara në të holla t'i shfrytëzojë për blerjen e pyllit tjetër, të tokës tjetër pyjore ose për ngritjen e pyjeve të reja, brenda afatit të përcaktuar me bazën ekonomiko pyjore.

Kushti nga paragrafi 1 i këtij neni nuk ndikon në vlerësimin e punës juridike.

Për tjetërsimin e pyllit dhe të tokës pyjore nga paragrafi 1 i këtij neni, që gjendet në kufijtë e rajonit ekonomiko-pyjor, pëlqimin e jep kuvendi i komunës.

Neni 7

Personi shoqëror-juridik nga bartësi i të drejtave të pronësisë mund të fitojë ndërtesat, përkatësisht banesat dhe lokalet afariste si pjesë të vecantë të ndërtesës.

Përsoni shoqëror-juridik, ndërtesat, përkatësisht banesat dhe lokalet afariste si pjesë të vecanta të ndërtesave mund t'i tjetërsojë nga pronësia shoqërore vetëm me shpërblim.

Neni 8

Kur ndërtesa familjare banesore ose banesa tjetërsohet nga pronësia shoqërore nëpërmjet shitjes me pagesë në kiste pagesa bëhet sipas kushteve dhe në mënyrën që nuk mund të jetë më e volitshme se kushtet sipas të cilave jipen kredi bankare për ndërtimin banesor. Blerësi nga paragrafi 1 i këtij neni nuk mund të shes ndërtesën familjare banesore respektivisht banesën, para kalimit të afatit prej pesë vjetësh.

Neni 9

Tjetërsimi i pasurisë së paluajtshme nga pronësia shoqërore bëhet me anë të ankandit publik, përkatësisht me marrjen e ofertave me shkrim, kurse me marrëveshjen e drejtëpërdrejtë bëhet vetëm atëherë kur tjetërsimi nëpërmjet ankandit publik, përkatësisht përmes paraqitjes së ofertave me shkrim, mbetet i pasuksesshëm.

Kontrata mbi tjetërsimin e pasurisë së paluajtshme nga pronësia shoqërore kundër dispozitës së paragrafit 1 të këtij neni është nulë.

Neni 10

Në qoftë se pronari i tokës bujqësore nuk mund të dokumentojë të drejtën e pronësisë me certifikatë nga librat përkatëse në të cilat regjistrohet e drejta e pronësisë në pasuri të paluajtshme ose me aktvendim të formës së prerë të marrë në bazë të ligjit mbi shqyrtimin e marrëdhënieve pronësore të krijuara me uzurpimin arbitrar të tokave në pronësinë shoqërore, ai mund t'ia shesë tokën personit shoqëror-juridik ose të bëjë ndërrimin me tokën e pronësisë shoqërore në bazë të vërtetimit të organit komunal të administratës, kompetent për punë pronësore-juridike se është pronar i kësaj toke. Me qëllim të marrjes së vërtetimit nga paragrafi 1 i këtij neni pronari i tokës ka për detyrë që të dokumentojë:

1. se pronësinë e tokës e fituar sipas njerës nga bazat juridike në bazë të të cilave fitohet e drejta e pronësisë së pasurisë së paluajtshme dhe se ky dhe paraardhësit e tij juridikisht janë në posedim të përhershëm të tokës,
2. se nuk zhvillohet kontesti gjyqësor për pronësinë në këtë tokë, përkatësisht se nuk është lëndë ekzekutimi,

3. se në librat kadastrale është shënuar si posedues i kësaj toke.

Neni 11

Bartësi i të drejtës së pronësisë mundet, me deklaratë të njëanshme, të heqë dorë nga pronësia për pasurinë e paluajtshme në dobi të komunës në territorin e së cilës gjendet pasuria e paluajtshme, nëse në të nuk ka ndonjë barrë, pos servitutit real.

Deklarata mbi heqjen dorë në pajtim me paragrafin 1 të këtij neni jepet para organit komunal të administratës, kompetent për punët pasurore-juridike dhe shërben si bazë për regjistrimin në librat përkatëse në të cilat mbahet evidenca e pasurisë së paluajtshme në pronësinë shoqërore.

Neni 12

Kontrata në bazë të së cilës personi shoqëror-juridik e tjetëron pasurinë e paluajtshme nga pasuria shoqërore në dobi të bartësit të të drejtave të pronësisë dhe kontrata në bazë të së cilës personi shoqëror-juridik e blen pasurinë e paluajtshme nga bartësi i të drejtave të pronësisë mund të anulohet në qoftë se cmimi i kontraktuar është në jopërpjestim të qartë me vlerën qarkulluese të pasurisë së paluajtshme në kohën e lidhjes së kontratës dhe në qoftë se me këtë do të dëmtohet pronësia shoqërore.

Me vlerë qarkulluese të pasurisë të paluajtshme nga paragrafi 1 i këtij neni nënkuptohet cmimi i pasurisë së paluajtshme përkatëse që arrihet në qarkullimin e lirë në kohën e lidhjes së kontratës në vendin ku gjindet kjo pasuri e paluajtshme ose në rrethinën e saj të afërme.

Aplikimi i dispozitës së paragrafit 1 të këtij neni nuk mund të përjashtohet me kontratë.

Neni 13

Gjykata e cila e bënë vërtetimin e nënshkrimit në kontratë ka për detyrë që një kopje të kontratës nga neni 12 i këtij ligji t'ia dërgojë avokatit publik të komunës në territorin e së cilës gjindet pasuria e paluajtshme në afat prej 15 ditësh prej ditës së vërtetimit të bërë. Në qoftë se gjenë se kontrata mbi qarkullimin e pasurisë së paluajtshme është lidhur në kundërshtim me kushtet e përcaktuara në nenin 8 dhe 12 të këtij Ligji, avokati publik do të paraqesë padi për anulimin e kontratës në afat prej gjashtë muajve prej ditës së marrjes së kontratës.

Kontrata nga paragrafi 2 i këtij neni nuk do të anulohet në qoftë se në procedurën të cilën e ka zhvilluar avokati publik e përshtat për kah forma me dispozitat e këtij ligji. Me dispozitat e paragrafit 2 dhe 3 të këtij neni nuk cenohen të drejtat e palëve të kontraktuara që të kërkojnë anulimin e kontratës sipas bazës tjetër.

Neni 14

Në padinë për anulimin e kontratës sipas nenit 13 të këtij ligji avokati publik do të kërkojë që palët kontraktuese të kthejnë pasurinë e paluajtshme, përkatësisht shumën në të holla të paguar në emër të cmimit të blerjes.

Kërkesa për kthimin e pasurisë së paluajtshme mund të paraqitet edhe ndaj personit të tretë, në qoftë se me rastin e fitimit të pasurisë së paluajtshme ka qenë i pavetëdijshëm. Në qoftë se kërkesa për kthimin e pasurisë së paluajtshme nuk mund të paraqitet me sukses ndaj personit të tretë, avokati publik mundet nga blerësi, përkatësisht nga shitësi të kërkojë diferencën ndërmjet cmimit të blerjes dhe vlerës qarkulluese të cilën e ka pasur pasuria e paluajtshme në kohën e shitjes.

Neni 15

Kontratën mbi shitjen, bartjen dhe tjetërsimin e pasurisë së paluajtshme me të cilat disponon bashkësia shoqërore-politike e lidh personi i autorizuar në bazë të aktit të kuvendit të bashkësisë shoqërore-politike ose të organit të cilin e cakton ky.

Kontratën mbi blerjen, bartjen dhe tjetërsimin e pasurisë së paluajtshme nga mjetet e konsumit të përbashkët të bashkësisë punonjëse të organit të bashkësisë shoqërore-politike e lidh personi i autorizuar në bashkësinë punonjëse në pajtim me aktin e përgjithshëm vetëqeverisës të bashkësisë punuese.

Neni 16

kontratën mbi blerjen, bartjen dhe tjetërsimin e pasurisë së paluajtshme me të cilën disponon Krahina Socialiste Autonome e Kosovës e lidh sekretari Krahinor i Financave në bazë të aktit të këshillit Ekzekutiv të Kuvendit të Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës.

Neni 17

Para lidhjes së kontratës mbi blerjen dhe tjetërsimin e pasurisë së paluajtshme nga pronësia shoqërore, të cilën bashkësia shoqërore-politike e lidh me bartësin e të drejtave të pronësisë, kërkohet mendimi e avokatit publik kompetent mbi arsyeshmërinë e drejtës së kësaj pune juridike.

Neni 18

Dispozitat e nenit 8, 9, 12 dhe 13 të këtij ligji nuk kanë të bëjnë me shitjen e ndërtesave, të banesave, të lokaleve afariste dhe të pasurive të tjera të paluajtshme, të cilat personi shoqëror-juridik i vënë në qarkullim në kuadër të afarizmit të rregullt.

III. E DREJTA E PËRPARSISË PËR BLERJEN E PASURISË SË PALUAJTSHME

Neni 19

Bartësi i të drejtës së pronësisë i cili ka ndërmend ta shes tokën bujqësore, e ka për detyrë që më parë, me shkrim t'ia ofrojë: organizatës së punës së bashkuar e cila merret me prodhimin bujqësor dhe kooperativës bujqësore në territorin e komunës në të cilin gjendet toka, komunës në territorin e së cilës gjendet toka dhe bujku-poseduesit të tokës fqinjë.

Në rastin kur ka disa bujq-posedues të tokës fqinjë, toka bujqësore e të cilëve kufizohet me tokën bujqësore të shitësit, të drejtën e përparësisë për blerje e ka bujku-poseduesi i tokës fqinjë, toka bujqësore e të cilit kufizohet në pjesën më të madhe me tokën bujqësore të shitësit.

Bartësi i të drejtës së pronësisë i cili ka ndërmend ta shesë pyllin dhe tokën pyjore e ka për detyrë që më parë t'ia ofrojë organizatës së punës së bashkuar e cila qeverisë pyjet në territorin e komunës në të cilin gjenden pylli dhe toka pyjore dhe komunës në territorin e të cilës gjenden pylli dhe toka pyjore.

Oferta ng paragrafi 1 dhe 3 të këtij neni duhet të përmbajë të dhënat për tokën (numri i parcelës kadastrale, sipërfaqja, kultura, lokacioni më i afërt etj.), cmimin dhe kushtet e tjera të shitjes.

Nëse personat të cilëve u është dërguar oferta nuk deklarohen brenda 30 ditësh se e pranojnë ofertën, bartësi i të drejtës së pronësisë mundet që tokën bujqësore, pyllin ose tokën pyjore t'ia shes tjetrit, por jo me kushte më të volitshme për blerësin.

Realizimi i të drejtës së përparësisë në blerje bëhet: sipas radhës së bartësve të kësaj të drejte të përcaktuar në paragrafet 1 dhe 3 të këtij neni.

Neni 20

Bartësi i të drejtave të pronësisë i cili dëshiron ta shesë tokën në rajonin e ndërtimit, ka për detyrë që së pari t'ia ofrojë për shitje komunës në territorin e së cilës gjendet toka. Dispozitat e nenit 19 të këtij ligji aplikohen edhe në qarkullimin e pyjeve dhe të tokës pyjore në rajonin e ndërtimit.

Dispozita e paragrafit 1 të këtij neni ka të bëjë me tokën për ndërtim të përfshirë me planin urbanistik, si dhe me tokën për ndërtimin në kufijtë e rajonit ndërtimor, të cilën me vendim e ka përcaktuar kuvendi i komunës.

Për ofertën e paraqitjes me shkrim për shitjen e tokave deklarohet organi ose organizata të cilën e cakton kuvendi i komunës.

Neni 21

Bartësi i të drejtave të pronësisë, i cili dëshiron ta shesë ndërtesën familjare banesore ose banesën, ka për detyrë që këtë ndërtesë ose këtë banesë së pari t'ia ofrojë për shitje komunës në territorin e së cilës gjindet ndërtesa ose banesa.

E drejta e përparësisë së blerjes realizohet sipas radhitjes së përcaktuar me paragrafin 1 të këtij neni.

Neni 21-a

Kur ndërtesa familjare banesore ose banesa tjetër nga pronësia shoqërore, personi shoqëror-juridik e ka për detyrë që më parë me shkrim t'ia ofrojë për blerje bartësit të së drejtës banesore-shfrytëzuesit të banesës.

Personi shoqëror-juridik e ka për detyrë që ofertën ta dërgojë me letër rekomande ose me shkresë nëpërmjet gjykatës dhe ta kumtojë cmimin, si dhe kushtet e tjera të shitjes.

Nëse personi të cilit i është dërguar oferta nuk deklarohet brenda afatit prej 30 ditësh se e pranon ofertën, personi shoqëror-juridik mundet që ndërtesën familjare banesore ose banesën t'ia shes personit tjetër, pajtimisht me dispozitat e nenit 9 të këtij ligji.

Nëse ndërtesa familjare banesore, përkatësisht banesa tjetërsohet nga pronësia shoqërore, duke ia shitur personit tjetër në vështrim të paragrafit 3 të këtij neni, bartësi i të drejtës banesore-shfrytëzuesi i banesës mbanë të drejtat dhe obligimet e bartësit të së drejtës banesore të përcaktuara me ligj, kurse poseduesi i ndërtesës familjare banesore, përkatësisht i banesës i ka të gjitha të drejtat dhe obligimet e dhënësit të banesës në shfrytëzim sipas nenit 86 paragrafi 2 dhe 3 të Ligjit mbi marrëdhëniet banesore.

Neni 22

Bartësi i të drejtave të pronësisë i cili dëshiron ta shesë lokalin afarist ka për detyrë që së pari t'ia ofrojë për shitje bashkëpronarit-marrësit me qira, i cili këto lokale afariste drejtpërdrejtë i shfrytëzon së paku 5 vjetë, përkatësisht komunës në territorin e së cilës gjindet lokali afarist.

E drejta e përparësisë së blerjes realizohet sipas radhitjes së përcaktuar me paragrafin 1 të këtij neni.

Neni 23

Oferta nga neni 19 deri 22 të këtij ligji duhet të jetë me shkrim dhe duhet t'i përmbajë të dhënat mbi pasurinë e paluajtshme (numrin e parcelës kadastrale, sipëraqen, kulturën, lokacionin e afërt dhe të ngjajshëm) cmimin dhe kushtet tjera të shitjes.

Oferta dërgohet me postë rekomandë ose t'i dorëzohet drejtpërsëdrejti organit ose organizatës kompetente me vërtetimin e pranimit të ofertës.

Neni 24

Në qoftë se poseduesi i të drejtave të përparësisë së blerjes nuk e informon me shkrim pronarin e pasurisë së paluajtshme mbi marrjen e ofertës në afat prej 30 ditësh prej ditës së marrjes së ofertës, bartësi i së drejtës të pronësisë mund t'ia shesë pasurinë e paluajtshme të ofruar personit tjetër por jo me cmim më të ulët as me kushte më të volitshme.

Neni 25

Në qoftë se poseduesi i të drejtave të pronësisë nuk e bënë shitjen e pasurisë së paluajtshme në afat prej një viti pas kalimit të afatit për pranimin e ofertës, ka për detyrë në rast të rishitjes, që të veprojë sipas dispozitave të nenit 19 deri 22 të këtij ligji.

Neni 26

Gjykata do të rrefuzojë me aktvendim kërkesën për vërtetimin e nënshkrimit në kontratë, nëse bartësi i së drejtës banesore nuk prezanton dëshmitë se e ka bërë ofertën në vështrim të neneve 19 deri 22 të këtij ligji.

Nëse bartësi i të drejtës banesore nuk e bënë ofertën në vështrim të neneve 19 deri 22 të këtij Ligji, përkatësisht nëse pas ofertës së bërë pasurinë e paluajtshme ia shet personit të tretë me kushte më të volitshme, personi i cili e ka të drejtën e përparësisë në blerje mundet që me padi të gjykata të kërkojë që kontrata mbi shitjen të anulohet dhe që atij ti shitet pasuria e paluajtshme sipas të njëjtave kushte.

Padia nga paragrafi 2 i këtij neni mund të paraqitet brenda një viti nga dita kur bartësi i të drejtës së përparësisë në blerje ka mësuar së pasuria e paluajtshme është shitur personit të tretë, e më së voni brenda 3 vjetësh nga dita e lidhjes së kontratës mbi shitjen. Paditësi e ka për detyrë që brenda afatit për paraqitjen e padisë për shkak të shkeljes së të drejtës së përparësisë në blerje, të gjykata komunale në territorin e së cilës gjendet pasuria e paluajtshme, të deponojë shumën në lartësinë e cmimit të shitblerjes.

Neni 26a

Nëse kontrata mbi shitjen e pasurisë së paluajtshme nuk është lidhur në formën e përcaktuar me këtë ligj, kurse pasuria e paluajtshme i është dhënë blerësit në posedim, do të konsiderohet se në këtë mënyrë është bërë shkelja e të drejtës së përparësisë në blerje, andaj, personi që e ka këtë të drejtë mund të kërkojë realizimin e saj brenda afatit prej një viti nga dita kur ka mësuar për lidhjen e kontratës.

V. DISPOZITAT E VECANTA

Neni 27

Gjykata ka për detyrë që një kopje të vendimit të trashëgimit përkatësisht një kopje të kontratës mbi qarkullimin e pasurisë së paluajtshme përvec kontratës mbi bartjen e pasurisë së paluajtshme në pronësinë shoqërore prej një personi shoqëror-juridik në personin tjetër, t'ia dërgojë organit komunal të administratës kompetente për punë të gjeodezisë.

Në qoftë se organi komunal i administratës kompetent për punë të gjeodezisë gjen se bartësi i së drejtës së pronësisë në bazë të trashëgimit e ka fituar pasurinë e paluajtshme mbi kufijtë e të drejtës pronësore, avokati publik komunal ia paraqet paraqitjen për hapjen e procedurës për anulimin e kësaj pune juridike.

VI. DISPOZITAT NDËSHKIMORE

Neni 28

Me gjobë ose me dënim burgim deri më tre vjet do të dënohet për vepër penale personi i cili merret me stërshitjen e pasurisë së paluajtshme ose i cili me kompensime bën ndërmjetësimin në qarkullimin e pasurisë së paluajtshme.

Neni 29

Do të gjobitet për kundërvajtje deri në 50.000 dinarë organizata e punës së bashkuar, e cila tokën bujqësore, pyllin ose tokën pyjore e tjetëron nga pronësia shoqërore në kundërshtim me dispozitat e neneve 5 dhe 6 të këtij ligji.

Për kundërvajtje nga paragrafi 1 do të gjobitet edhe personi përgjegjës në organizatën e punës së bashkuar deri në 5.000 dinarë.

Neni 30

Do të gjobitet për kundërvajtje deri në 50.000 dinarë personi shoqëror-juridik i cili ndërtesën e banimit ose banesën e tjetëron nga pronësia shoqërore në kundërshtim me dispozitat e nenit 8 paragrafi 1 të këtij ligji.

Për kundërvajtje nga paragrafi 1 i këtij neni do të gjobitet deri në 5.000 dinarë edhe personi përgjegjës në personin juridik-shoqëror.

Do të gjobitet për kundërvajtje deri në 30.000 dinarë bartësi i së drejtës pronësore, i cili shet ndërtesën familjare të banimit ose banesën para kalimit të afatit nga neni 8 paragrafi 2 i këtij ligji.

Neni 31

Do të gjëboret për kundërvajtje deri në 5.000 dinarë personi i cili e fiton me trashëgim pasurinë e paluajtshme mbi kufijtë e caktuar me ligj, e këtë nuk ia paraqet organit komunal të administratës kompetente për punë pronësore-juridike në afatin nga neni 3 paragrafi 1 i këtij ligji.

VI. DISPOZITAT KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 32

Ditën e hyrjes së këtij ligji në fuqi shfuqizohet Ligji për qarkullimin e pasurisë së paluajtshme ("Gazeta zyrtare e KSAK", nr. 18/75).
Procedura e filluar sipas dispozitave të këtij ligji për qarkullimin e pasurisë së paluajtshme ("Gazeta zyrtare e KSAK", nr. 18/75) do të përfundojë sipas dispozitave të këtij ligji.

Neni 32a

Përfshihet nga dispozitat e Ligjit me të cilat rregullohet qarkullimi i paluajtshmërisë përkohësisht, ndalohet qarkullimi i paluajtshmërisë ku qytetarët dhe personat civilo-juridik kanë të drejtën e pronësisë nëse qarkullimi i paluajtshmërisë bëhet për shpërnguljen e pjesëtarëve të kombeve e të kombësive nga territori i Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës.

Ndaloja e qarkullimit të paluajtshmërisë nga alineja 1 e këtij neni mund të zgjatë derisa ekzistojnë arsyet për të cilat është përcaktuar dhe më së largu deri 31 dhjetor 1990.

Neni 32b

Është nule kontrata mbi qarkullimin e paluajtshmërisë e cila është lidhë në kundërshtim me dispozitën e nenit 32a të këtij Ligji.

Neni 32c

Sipas kontratave të cilat në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji nuk janë vërtetuar në gjyq nuk mund të bëhet bartja e të drejtës së pronësisë.

Neni 32d

Autorizohet drejtori i Drejtorisë krahinore për punët pasurore-juridike që të bëjnë Udhëzimin për zbatimin e dispozitave të nenit 32a, 32b dhe 32c, të këtij Ligji.

Neni 33

Ky ligj hyn në fuqi ditën e tetë pas ditës së shpalljes në "Gazetën zyrtare të Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës".

Neni 8

Autorizohet komisioni legjislativo-juridik i Kuvendit të Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës që të përcaktojë tekstin e spastruar të Ligjit për qarkullimin e pasurisë së paluajtshme.

Vërejtje: Neni 8 është nxjerrë në bazë të ndryshimeve dhe plotësimeve të këtij ligji ("Gazeta zyrtare e KSAK", nr. 28/88. Ky nen nuk ka mund të zënë vend sipas radhitjes kronologjike, sepse me atë numër gjendet neni nga dispozita bazë.

